



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:920225

Datë: 18.12.2020

Numri i dokumentit: 01354252

Ae.nr.301/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjenjuridike të paditësit Shoqëria Tregtare [“C...”] sh.p.k, me seli në Suharekë, të cilën me autorizim e përfaqëson [B.K], avokat nga Suhareka, kundër të paditurës Shoqëria Tregtare [“T...”], me seli në Suharekë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [I.D], avokat nga Prishtina, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.428/2016, të datës 30.07.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.12.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Shoqëria Tregtare [“C...”] sh.p.k., me seli në Suharekë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.428/2016, të datës 30.07.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar në piken I të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Shoqëria Tregtare [“C...”] sh.p.k., me seli në Suharekë, metë cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri [“T...”], me seli në Suharekë, që në emër të borxhit të pa paguar paditësit t’ia paguaj shumën prej 18,458.85€, me kamatë ligjore brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ndërsa në piken II të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar paditësi që palës së paditur t’ia paguaj shumën prej 1,580.00€ në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi Shoqëria Tregtare [“C...”] sh.p.k., me seli në Suharekë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës

kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material, me propozimin që Gjykata Apelit në Prishtinë ta aprovoje ankesën e paditëses si të bazuar dhe aktgjykimin I.EK.nr.428/16 të datës 30.07.2019 ta ndryshoje ose lëndën ta kthejë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Shoqëria Tregtare ["C..."] sh.p.k., me seli në Suharekë, me datën 17.12.2016, ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë kundër të paditurës Shoqëria Tregtare ["C..."], me seli në Suharekë, për shkak të kompensimit të borxhit, ku ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar kërkesëpafia e paditësit Ndërmarrja ["C..."], me seli në Suharekë, dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 18,458.85€ në emër të borxhit të pa paguar sipas faturave dhe barazimit në mes palëve, me kamatë ligjore nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur së ndërmjet palëve nuk ishte kontestuese fakti se paditësi dhe i padituri kanë qenë në raport afarist, ku pala paditëse e ka furnizuar palën e paditur me mallra siç janë çimento dhe karburante dhe se sipas marrëveshjes pagesa do të behej pas lëshimit të faturave. Palët me datën 30.05.2013 kanë bërë barazimin e gjendjes ku është kanë hartuar shkresa në të cilën janë përcaktuar vlera e furnizimit të bërë nga pala paditëse dhe shuma e pagesave të kryera nëpërmjet llogarisë bankare dhe në kesh. Sipas kësaj shkrese paditësi e ka furnizuar të paditurin me mallra në vlerën prej 196,924.92€, ndërsa i padituri ia ka paguar në kesh shumën prej 178,476.07€ ku pala e paditur ka mbetur në obligim në shumën prej 18,457.85€. Në procesin e barazimit nuk janë të cekura numri i faturave të paguara e as numri i faturave të cilat kanë mbetur të pa paguara, gjegjësisht nuk dihet se shumat e paguara cilave faturave u janë referuar. Ishte jo kontestuese në mes palëve se pala paditëse ka iniciuar procedure përmbartimore duke u bazuar në procesin e barazimit të datës 30.05.2013, ku përmbartuesi privat ka lëshuar urdhrin përmbartimor mirëpo Gjykata Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, me aktvendimin P.nr.18/15 e ka anuluar urdhrin e përmbartimit me arsyetimin së dokumenti është jo autentik për përmbartim.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se objekti i shqyrtimit ishte edhe çështja se a i ka kryer të gjitha pagesat pala e paditur ndaj palës paditëse për mallrat e pranuar dhe se a ekziston realisht borxhi i pretenduar në shumën prej 18,457.85€. Eksperti gjyqësorë financiarë në raportin e tij ka dhënë mendimin se pala e paditur nuk ka detyrim të pa shlyer ndaj palës paditëse dhe sipas llogaritjeve që ka bërë eksperti pala e paditur ka kryer pagesa më tepër në dobi të palës paditëse dhe atë në shumën prej 9,827.06€. Pas shqyrtimi të raportit të ekspertizës si dhe provave tjera gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se eksperti i angazhuar në këtë çështje ka dhënë mendim profesional në lidhje me sasinë e pagesave të kryera nga pala e paditur.

Ekspertiza e tij është profesionale është arsyetuar në masë të mjaftueshme, është e plotë si dhe është në përputhje të plote me shkresat e lëndës andaj dhe ia ka falur besimin.

Prandaj, Gjykata e shkallës së parë mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 245 paragrafi 1, nenin 8 paragrafi 1 të LMD-së si dhe në nenin 452.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 8.1 të LMD-së me të cilin është përcaktuar se *“pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”*. Ndërsa në dispozitën e nenit 245 paragrafi 1 të LMD-së është përcaktuar se *“kreditoret në raporte detyrimore është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitorit është përgjegjës ta përmbushë detyrimin e tij në mënyrë të ndërgjegjshme”*. Ne rastin konkret nga provat e lëndës dhe nga ekspertiza financiare është vërtetuar se palët kanë qenë në raport afarist të rregullte, ku pala paditëse e ka furnizuar me mall palën e paditur dhe se pala e paditur i ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj. Nga ekspertiza financiare të punuar nga z. [Sh.M] me datën 25.02.2019 rezulton se pala e paditur nuk ka detyrim të pa shlyer ndaj palës paditëse edhe sipas llogaritjeve që ka bërë eksperti në ekspertizë pala e paditur ka kryer pagesa më tepër në dobi të palës paditëse në shumën prej 9,827.06€. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e palës paditëse lidhur me borxhin e pretenduar nuk janë vërtetuar me asnjë provë materiale me të cilën do të vërtetohej baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e palës paditëse lidhur me atë së gjykata e shkallës së parë nuk ka marr për bazë marrëveshjen mbi barazimin e gjendjes financiarë të lidhur në mes palëve më datën 30.05.2013, mirëpo kjo gjykate këto pretendime i vlerëson si të pabazuara me arsyetimin se kjo pasqyrë financiare nuk përmban ndonjë analize të raportit kontraktual, nuk pasqyron gjendjen e faturave dhe nuk është në përputhje me dokumentacionin si dhe me ekspertizën financiare.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e palës se paditëse janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me

Numri i lëndës: 2020:920225
Datë: 18.12.2020
Numri i dokumentit: 01354252

arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ae.nr.301/2019, dt.15.12.2020

KRYETARI I KOLEGJIT

Mahir Tutuli, d.y.

